

Një tjetër shqiptar besohet të jetë vrarë gjatë luftës në Siri. Bëhet fjalë për një qytetar të etnisë shqiptare të Maqedonisë, nga një fshat i Strugës, me shtetësi austriake dhe që ka jetuar prej vitesh në Austri dhe në vendet e Lindjes së Mesme, raporton "Strugalajm".

Portali shkruan se familjarët janë lajmëruar për vrasjen e djalit të tyre, por nuk dihet se në ç'rrethana ka humbur jetën shqiptari.

Edhe policia ka informuar se është vrarë një shqiptar, që ka jetuar dikur në një fshat të Strugës, i cili kishte hequr dorë prej vitesh nga shtetësia e Maqedonisë.

"Këto burime nuk saktësojnë rrethanat dhe vendin ku është vrarë strugani, por konfirmojnë me siguri të lartë se ai është vrarë dhe tashmë familja e viktimës është informuar për këtë ngjarje. Në rrugë jozyrtare ky informacion konfirmohet edhe nga burime policore, nga ku thonë se personi në fjalë prej disa vitesh kishte hequr dorë nga shtetësia e Maqedonisë dhe ka jetuar në Austri, si dhe në Siri ku edhe ka krijuar një familje të re", shkruan ky portal.